

Thirrje publike për në Këshillin Vendor të Rinisë në Bashkisë Pogradec

Bashkia Pogradec shpall thirrjen publike për anëtarësim në Këshillin Vendor të Rinisë, i cili do të jetë organ këshillimor që funksionon pranë Bashkisë Pogradec për çështjet në lidhje me rininë.

Thirrja është e hapur për të gjithë të interesuarit të cilët plotësojnë kriteret. Kandidati/ja duhet të jetë banorë të Bashkisë Pogradec, mosha nga 15 – 29 vjet.

*Mirëpresim çdo aplikim deri më 22 nëntor 2022 ,dokumentet të dorëzohen pranë Zyrës së Protokollit në Bashkinë Pogradec dhe për cdo paqartësi mund të shkruani në adresën tonë email: gendrarinorepograde@gmail.com me subjektin “Aplikim për anëtarë të KVR-së”. Rikujtojmë se çdo aplikim që nuk përmbush kriteret e mëposhtme, nuk do të kualifikohet për fazën e mëtejshme.

Kandidati për anëtar i KVR-së, përfaqësues i rinisë aktive, i organizatave rinore / jo përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kriteret:

1. Të ketë dhënë kontribut / të ketë përvojë në fushën e rinisë të paktën 2 vitet e fundit, nëpërmjet projekteve me fokus rininë apo zhvillimit të nismave/aktiviteteve për promovimin e të rinjve;
2. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
3. Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

Nëse mendoni se plotësoni kriteret për të qenë pjesë e Këshillit Vendor Rinor, ju lutem bashkëngjisni në aplikimin tuaj dokumentat e mëposhtme:

1. Kandidati, përfaqësues i organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë duhet të ngarkojë:
 - 1.1. Kërkesën për aplikim
 - 1.2. Curriculum Vitae, CV
 - 1.3. Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj
 - 1.4. Vetëdeklarim i konfliktit të interesit

2. Kandidati, jo përfaqësues i organizatave rinore duhet të ngarkojë:

2.1. Kërkesën për aplikim

2.2. Curriculum Vitae, CV

2.3. Vetëdeklarim i konfliktit të interesit

2.4. Letër motivimi

Thirrja për aplikim për kandidaturat e lartëpërmendura publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec: www.bashkiapogradec.gov.al për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhje e tyre bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve.

Rezultati i përzgjedhjes nga komisioni i ngritur do shpallet nga kryetari i bashkisë dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec: www.bashkiapogradec.gov.al .